



15.06.2021

STATUTI I SHOQERISE TREGTARE

“UMBRELLA”

Neni 1

Forma ligjore, Selia

1. Shoqeria **“Umbrella”** është person juridik, me statusin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, e cila ushtron aktivitetin tregtar ne gjithë territorin shqiptar.

2. Selia e saj ndodhet ne qytetin e Fierit ne adresen Lagja: 8 shkurti, Rruga: Mujo Ulqinaku, Fier, zona kadastrale 8533, nr.i pasurise 3/79-N1, Rajoni 3, Fier.

3. **“Umbrella”** funksionon në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin 9901, nr. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqerite tregtare”, i ndryshuar, këtë Statut dhe Akt Themelimit e saj, dhe legjislacionin në fuqi.

4. Themeluesi i Shoqerise është përgjegjës për veprimtarinë e saj. Ai, me nënshkrimin e Aktit të Themelimit dhe Statutit, merr përsipër të realizojë e të respektojë detyrimet që rrjedhin nga këto akte dhe legjislacioni në fuqi

Neni 2

Shkurtimi, Flamuri, Emblema, Vula dhe Gjuha.

1. Emërtimi i Shoqerise si shoqeri tregtrate do të jetë **“Umbrella”**

2. Shoqeria perbehet nga nje **Ortak** I cili është edhe **Administrator** i vetem, **Travis James Dearborn**, I datelindjes 18. 09.1971, cili zgjidhet me afat 5 vjecar.

3. **“Umbrella”** ka siglën, simbolin dhe vulën e saj të cilat e identifikojnë atë. Vula mban mbishkrimin **“Umbrella”** si dhe logon e miratuar nga Administratori

Neni 3

Objektivat

Qëllimi dhe fusha e veprimtarisë së shoqerise **“Umbrella”**.

a) **“Umbrella”** ka si qellim te ushtroje aktivitet tregtar ne fushat e meposhtme:

b) Te furnizojë kompani vendase dhe te huaja me fuqi punetore te fushave te ndryshme, si punetore krahu, shofere te klasave te ndryshme, specialiste minatore, specialist pusesh



nafte, specialist ne fushen e marredhenieve me publikun, autoritetet publike dhe kompensimin e demeve, inxhinierë gjeologë, inxhinierë sizmike, specialiste dhe inxhinierë ne fushen e mjedisit, teknike kabllorësh dhe gjeofonësh, elektrikist dhe teknike ne fushen e elektricitetit, hidraulik dhe specialist ne fushen e utesjellesave, specialist ne fushen e eksplozivit dhe lendeve plasese, teknike saldatore, teknike dhe staf ndertimi, murator, bojaxhi, hekurkthyes dhe teknik per punime me hekura, infermiere, doktore dhe staf teknik te ndihmes se shpejte, specialist ne mbrojtjen kunder zjarrit, perkthyes dhe juriste te fushave te ndryshme, punonjes social dhe psikologe.

- c) Te jape asistencë profesionale teknike dhe ligjore ne lidhje me sigurine e jetes dhe shendetit ne pune. Te organizoje kurse trajnimi per mbrojtjen nga zjarri dhe perdorimin e fikseve te zjarrit, per ndihmen e pare ne rast aksidenti, per mbrojtjen nga gazrat helmues si dhe sigurine teknike ne pergjithesi, ne perputhje me standartet nderkombetare.
- d) Te organizoje kurse trajnimi profesional.
- e) Te ushtroje aktivitet tregtar ne sigurimin e objekteve, sendeve dhe materialeve te ndryshme, me roje civile si dhe me sistem kamerash.
- f) Te ushtroje aktivitet tregtar ne fushen e lendeve drusore, mbjelljen, kultivimin dhe shitjen e tyre.
- g) Te ushtroje aktivitet tregtar ne fushen e bimeve te ndryshme si medicinale, mjeksore, dhe frutore si dhe te tjera lloje qe nuk perfshihen ne keto kategori. Te ushtroje aktivitet ne mbjelljen kultivimin, mbajtjen dhe shitjen e tyre.
- h) Te ushtroje aktivitet tregtar ne fushen e peshkimit, ne kapjen, kultivimin dhe shitjen e llojeve te peshkut dhe produkteve te tjera ujore.
- i) Te ushtroje aktivitet ne kultivimin dhe tregtimin e kerpudhave dhe te frutave ekzotike.
- j) Te ushtroje aktivitet ne sportet dhe produktet sportive te ndryshme dhe te ligjshme si dhe ne mesimdhene ne fushen e sporteve.
- k) Te ushtroje aktivitet tregtar ne fushen e turizmit malor dhe detar, te hotelerise, te kampingut malor dhe fushor.
- l) Te ushtroje aktivitet tregtar ne fushen e fast food-ve dhe Mc Donalds
- m) Te ushtroje aktivitet tregtar ne tregun immobilar, ne shitblerjen e pasurive te paluajtshme, dhenie me qera, shkembim pronash, shitblerje ne ankand.
- n) Te ushtroje aktivitet tregtar ne fushen e shitblerjes se automjeteve te ndryshme,
- o) Te ushtroje aktivitet tregtar ne fushen e veshjeve te trupit dhe te kembes, si dhe ne fustane nuserie, kostume dhe aksesore per dasma.
- p) Te ushtroje aktivitet tregtar ne tregtimin e pajiseve te ndryshme elektronike
- q) Te ushtroje aktivitet tregtar ne fushen e bujqesise dhe blegtorise.
- r) Te ushtroje aktivitet tregtar ne fushen e duhanit dhe aksesoreve te tij.
- s) Te ushtroje aktivitet tregtar ne fushen e pijeve te ndryshme si vere, birre, pije alkolike dhe joalkolike.
- t) Te ushtroje aktivitet ne fushen e produkteve te kozmetikes.
- u) Te ushtroje aktivitet ne fushen e gjuetise se kafsheve.

Neni 4 Organet drejtuese

1. Organi më i lartë vendimmarrës i "Umbrella" është Asambleja e Përgjithshme.



2. Organet me i larte ekzekutive të **“Umbrella-së** eshte Administratori, I cili eshte ortaku i vetem i shoqerise, z. **Travis James Dearborn**, I datelindjes 18. 09.1971, me adrese Lagja:”8 Shkurti”, Rruga “Mujo Ulqinaku”, Godine 4 kateshe,Zona Kadastrale 8533, Nr pasurie3/79-N1 Rajoni 3, Fier

Neni 5 Mjetet financiare

1. Shoqeria perbehet nga nje ortak i vetem.
2. Kapitali i nevojshem për arritjen e qëllimit të Shoqerise investohet nga themeluesi dhe perbehet nga 1 pjese, me kapital 1 000 lek.
3. Burim i të ardhurave të **“Umbrella** janë vet-financimi i saj nga ana e themeluesit në mënyrë të vazhdueshme, të ardhurat nga veprimtaria e tregtare, fonde dhe donacione të ndryshme të përfituara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6 Kohëzgjatja

1. **“Umbrella**, krijohet për një afat të pacaktuar.
2. Përfundimi apo kufizimi i veprimtarisë së saj bëhet me vendim të motivuar të Administratorit ose për shkaqe dhe sipas mënyrave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 7 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë themelimit dhe ushtrimit të veprimtarisë zgjidhen me mirëkuptim dhe konsensus.
2. Në të kundërt, kompetente për mosmarrëveshjet që mund të lindin në Shoqeri, do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier.

Neni 8 Dispozita të fundit

1. Ky Statut përpilohet në 2 kopje origjinale, në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet pa vërejtje nga themeluesi i Shoqerise.
2. Një kopje depozitohet në zyrën QKB.

ORTAKU I VETEM

TRAVIS JAMES DEARBORN